



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.615/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët-përdorimi i institucioneve publike, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen më datë 17 Tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 14.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tre mijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

II. Detyrohet Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP A.nr.615/2021 më datë 12.10.2021, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Uran Ismaili, me datën 11.10.2021, rreth orës 23:30, për arsye elektorale në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë ka takuar stafin shëndetësor si dhe Drejtorin e kësaj Qendre. Më tej në ankesë parashtruesi i ankesës shton se ky aktivitet i kandidatit Uran Ismaili, ka qenë publik ngase i njëjti bashkë me drejtorin e kësaj qendre janë prononcuar për media pas përfundimit të aktivitetit në këtë qendër. Në

ankesë theksohet se drejtori i Qendrës Emergjente, kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjekti politik PDK, Uran Ismaili, gjatë prononcimit për media iu është referuar si “kryetar”. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi të kësaj ankese i ka bashkangjitur një CD-video incizim. Në ankesë kërkohet që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumente, masa e sanksionimit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në përgjigjen në ankesë të datës 13.10.2021, deklaroi se në vështrim të pretendimeve të palës ankuese, dhe në raport me legjislacionin përkatës zgjedhor në fuqi, PDK konsideron se ankesa Anr. 615/2021, nuk është e bazuar në ligj dhe po ashtu, nuk pasqyron drejtë dhe saktë gjendjen faktike duke ardhur në konstatime krejtësisht të gabuara. Në përgjigje në ankesë PDK, shtoi se është fakt i pa kontestueshëm se kandidati i tyre për kryetar të Komunës së Prishtinës, Uran Ismaili në kuadër të aktiviteteve elektorale të fushatës zgjedhore, pas të tjerash ka vizituar edhe Qendrën Emergjente të Prishtinës. Aty është njoftuar me sfidat dhe rrethanat në të cilën ofrohen shërbime 24 orë, në shtatë ditë të javës, dhe ka shprehur vlerësimin e tij për punën e rëndësishme që bën kjo qendër dhe për rëndësinë që do duhej të gëzonte në kuadër të shërbimeve komunale në Prishtinë. Më tej në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK, theksoi se kandidati Uran Ismaili, në respekt të plotë të punës dhe shërbimit të stafit të kësaj qendre, është solidarizuar me rrethanat në të cilat punonjësit i ofrojnë shërbimet, dhe se i njëjti këtë vizitë nuk e ka realizuar siç pretendon pala ankuese në kundërshtim me nenin 35 të LZP-së, veprime të ndaluara të Shërbyesve Publik, sepse sipas tyre i njëjti nuk mbanë ndonjë pozitë të lartë institucionale.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Subjekti Politik LVV me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë PZAP A.nr. 615/2021 më datë 12.10.2021, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Uran Ismaili, me datën 11.10.2021, rreth orës 23:30, për arsye elektorale në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, ka takuar stafin shëndetësor dhe Drejtorin e po të njëjtës

Qendër Emergjente, në kohë fushate, duke shfrytëzuar asetet publike, të cilët pas përfundimit të këtij aktiviteti së bashku janë prononcuar për media. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik PDK për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik PDK me datë 13.10.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Uran Ismaili, përmes veprimeve të tij, promovimit të subjektit të tij politik dhe vetvetes përmes prononcimit në media duke shfrytëzuar hapësirat në Qendrës Mjekësisë Urgjente të Prishtinës, pra asetet publike ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Kandidatët dhe Mbështetësit neni 35.1 e LZP-së, ku parashihet se *“Personi i cili mbanë pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj për qëllim të përfitimit të votave...”*

Pretendimi si në përgjigje në ankesë, se nuk ka qenë qëllimi i përfitimit elektorale, por ka qenë një vizitë e zakonshme në këto hapësira, nuk arsyeton publikimin e tyre në kohë të fushatës, kur secili veprim i secilit kandidat për kryetar, apo asambleist nga cilido subjekt hynë në kategorinë e veprimeve të ndaluara të Kodit të Mirësjelljes të cekur më lartë, e të cilat veprime sanksionohen. Qëllimi i sanksionimit të këtyre veprimeve ka të bëjë me ruajtjen e neutralitetit të pasurisë apo pronës së institucioneve të Republikës së Kosovës, si pasuri e të gjithëve pa dallim.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik PDK, në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e këtij subjekti, Uran Ismaili, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës. Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi

edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik PDK, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtat ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosë dhe se nuk kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.615/2021 me datën 14.10.2021

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa komfor nenit 118 par 4 të LZP-së